



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 01/40
Datë: 11.04.2018

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 14/2017, me Rregulloren nr. 15/2017 dhe me Rregulloren nr. 16/2017, si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 11 prill 2018, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Miratohen procesverbalet nga mbledhjet 35, 36 dhe 37 të Qeverisë së Republikës së Kosovës.
2. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Ramush HARADINAJ

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 02/40

Datë: 11.04.2018

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 14/2017, me Rregulloren nr. 15/2017 dhe me Rregulloren nr. 16/2017, si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 11 prill 2018, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Miratohet Projektligji për Statusin e Punëtorëve të Arsimit Shqip të Republikës së Kosovës nga viti shkollor 1990/91 deri në vitin shkollor 1998/99.
2. Projektligji nga pika 1. e këtij vendimi i dërgohet Kuvendit të Republikës së Kosovës.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Ramush HARADINAJ



Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 03/40

Datë: 11.04.2018

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 4 paragrafi 2. të Ligjit nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësive Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 14/2017, me Rregulloren nr. 15/2017 dhe me Rregulloren nr. 16/2017, si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 11 prill 2018, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Miratohet në parim Nisma për negocimin e "Marrëveshjes për Shmangien e Tatimit të Dyfishtë dhe Parandalimin e Evazionit Fiskal lidhur me Tatimin në të Hyra dhe Kapital" në mes të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Republikës së Maltës.
2. Përgjatë negocimit të kësaj marrëveshjeje, Ministria e Financave obligohet të procedojë konform dispozitave të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të Ligjit nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare dhe dispozitave tjera ligjore në fuqi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Ramush HARADINAJ

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 04/40

Datë: 11.04.2018

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 4 paragrafi 2. të Ligjit nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 14/2017, me Rregulloren nr. 15/2017 dhe me Rregulloren nr. 16/2017, si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 11 prill 2018, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Miratohet në parim Nisma për negocimin e "Marrëveshjes për Shmangien e Tatimit të Dyfishtë lidhur me Tatimin në të Hyra dhe Kapital si dhe Parandalimin e Evazionit Fiskal" në mes të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Republikës së Lituanisë.
2. Përgjatë negocimit të kësaj marrëveshjeje, Ministria e Financave obligohet të procedojë konform dispozitave të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të Ligjit nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare dhe dispozitave tjera ligjore në fuqi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Ramush HARADINAJ


Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 05/40
Datë: 11.04.2018

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 14/2017, me Rregulloren nr. 15/2017 dhe me Rregulloren nr. 16/2017, si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 11 prill 2018, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Miratohet Koncept Dokumenti për Parandalimin dhe Kontrollin e Integruar të Ndotjes.
2. Obligohet Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e këtij vendimi, në pajtim me Rregulloren e Punës së Qeverisë.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Ramush HARADINAJ

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 06/40

Datë: 11.04.2018

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 4, 8, 44 dhe nenit 45 të Ligjit nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin nr. 03/L-205, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjesisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 14/2017, me Rregulloren nr. 15/2017 dhe me Rregulloren nr. 16/2017, si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 11 prill 2018, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Miratohet shqyrtimi i mëtejme i kërkesës për shpronësim të pronës e cila është prekur nga ndërtimi i Rrugës Nacionale N9, Prishtinë-Pejë, Segmenti Fushë Kosovë - Sllatinë, Zona Kadastrale Sllatinë e Madhe, Komuna e Fushë Kosovës, sipas tabelës të përshkruar nga evidencat kadastrale përkatëse për titullarin e pronës së paluajtshme, pozitën e saj në kuadër të projektit të interesit publik si dhe sipërfaqes së saj, e cila tabelë paraqet pjesë përbërëse të këtij vendimi.
2. Vlera e kompensimit të pronës do të caktohet nga Ministria e Financave, konform Ligjit nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin nr. 03/L-205 dhe Udhëzimit Administrativ nr. 02/2015 "Për zbatimin e metodave dhe kriterëve teknike të vlerësimit që do të përdoren për përlllogaritjen e shumës së kompensimit për pronën e paluajtshme që shpronësohet dhe dëmeve që kanë të bëjnë me shpronësimin".
3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen Departamenti i Shpronësimit (MMPH), Ministria e Infrastrukturës dhe Ministria e Financave.
4. Vendimi hyn në fuqi në datën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe në një gazetë me tirazh të madh në Kosovë.

Ramush HARADINAJ

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 07/40

Datë: 11.04.2018

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 3 paragrafi 1. të Ligjit nr. 04/L-163 për Mallrat e Liruara nga Tatimi Doganor dhe Mallrat me Tarifë Zero të Tatimit Doganor, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjesisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 14/2017, me Rregulloren nr. 15/2017 dhe me Rregulloren nr. 16/2017, si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 11 prill 2018, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohen lirimet nga tatimi doganor në import për mallrat (pajisjet e teknologjisë informative) të përcaktuara në shtojcën e këtij vendimi, me tatim zero doganor.
2. Obligohet Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Ramush HARADINAJ

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë

Shtojca

Kodi tarifor	Përshkrimi
8443 3100 00	- - Makinat që kryejnë dy apo më shumë funksione të printimit apo transmetimit me faks, në gjendje për t'u lidhur me makina automatike të procesimit të të dhënave apo me një rrjet
8443 32	- - Të tjera, në gjendje të lidhen në një makinë automatike të procesimit të të dhënave apo në një rrjet:
8443 3210	- - - Printerat:
8443 3210 90	- - - - Të tjera
8443 3900 00	- - Të tjera
8443 9990 00	- - -Të tjera
84715000	- Njësite procesuese ndryshe nga ato të nën krerëve 8471 41 apo 8471 49, nëse përmbajnë apo jo në të njëjtën karkase një apo dy të tipeve të mëposhtme të njërive: njësite e ruajtjes, njësite e hyrjes, njësite e daljes:
8471 5000 90	- - Te tjera
8471 8000 00	- Njësite e tjera të makinave të përpunimit automatik të të dhënave
847330	- Pjesët dhe plotësuesit e makinave të kreut Nr. 8471:
8473 3020 00	- - Montimet elektronike
8473 3080 00	- - Të tjera
847350	- Pjesët dhe plotësuesit të përshtatshme njëloj për përdorim me makinat e dy apo më shumë nga krerët Nr. 8470 deri 8472:
8473 5020	- - Montimet elektronike
8473 5020 10	- - Për përdorim me makinat e dy apo më shumë nga kreu Nr. 8473
8473 5020 90	- - Te tjera
8473 5080	- - Te tjera
8473 5080 10	-- Për përdorim me makinat e dy apo më shumë nga kreu Nr. 8473
8473 5080 90	- - Te tjera
8504 4030	- - Të një lloji të përdorur me aparatet e telekomunikimit, makinat e përpunimit automatik të të dhënave dhe njësitë e tyre:
8504 4030 90	- - - Të tjera
8504 4090 90	- - - - Të tjera
8517 6200 20	— Switchat dhe ruterat
8517 6200 90	- - - Të tjera
8518 2100 90	- - - Të tjera
8518 2200 90	- - - Të tjera
8523 49	- - Të tjera
8523 4910 00	- - - - Disqet digjitale të kthyeshëm (DVD)
8523 4920 00	- - - -Të tjera
8523 4990	- - - Të tjera:
8523 4990 10	- - - - Për riprodhimin e fenomeneve ndryshe nga tingulli apo imazhi (duke përjashtuar disqet optike me laser)
8523 4990 90	- - - - Të tjera

8523 5110 00	--- Të paregjistruara
8523 5190 00	--- Të tjera
8523 80	- Të tjera
8523 8010 00	-- Të paregjistruara
8525 8091 00	- - - Në gjendje vetëm të regjistrojnë zërin dhe imazhin e marrë nga kamera televizive
8525 8099 00	--- Të tjera
Monitoret tjerë	
8528 52	- - Për tu lidhur drejtpërdrejt dhe të jetë i dizajnuar për përdorim me një makinë për procesimin e të dhënave të kreut 8471:
8528 5210 00	- - -Të një lloji të përdorur vetëm apo kryesisht në një sistem automatik të procesimit të të dhënave të kreut 8471:
8528 5210 90	----- Të tjera
8528 5291	----- Me një ekran të teknologjis (LCD) kristal liquid:
8528 5291 10	----- Monokrome
8528 5291 90	----- Me ngjyra:
	----- Të tjera
85285299	--- Panelet e rrafshëta në gjendje për paraqitje vizuale të sinjaleve nga makinat për përpunimin e të dhënave në një shkallë të pranueshme të funksionimit
8528529910	--- Monokrome
8528529920-	-- Me ngjyra
8528529990	---Të tjera
8528 6200	- - Për tu lidhur drejtpërdrejt dhe të jetë i dizajnuar për përdorim me një makinë për procesimin e të dhënave të kreut 8471
8528 6200 10	- - - Që punojnë me anë të ekranit të sheshtë panel (për shembull, një mjet kristal leng), në gjendje të shfaq informacionin digital të rrjedhur nga makinat e përpunimit automatik të të dhënave
8528 6200 90	--- Të tjera
8528 7111 00	- - - - Montimet elektronike për trupëzimin në makinat e përpunimit automatik të të dhënave
8528 7115 00	- - - - Aparate me pajisje të lidhur rreth një mikroprocesori me modem të përfshirë për t'u lidhur me internetin duke pasur si funksion shkëmbimin ndëraktiv të informacionit, të afta në kapjen e sinjaleve televizive ("set top boxes me funksion komunikimi"),duke përfshirë edhe ato pajisje të inkuorpuara si pajisje me funksion regjistrimi apo riprodhimi, me kusht që ato ta përmbajnë karakterin të një set boxi me funksion komunikimi
8528 7119 00	--- Të tjera
8536 7000 00	- Konektorët për fibrat optike, grumbull të fibrave optike apo kablllove
8538 1000 00	- Bordet, panelet, konsolat, tavolinat, kabineteteve dhe bazave të tjera për mallrat e kreut Nr. 85.37, jo të pajisura me aparataturat e tyre



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 08/40

Datë: 11.04.2018

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 3 paragrafi 1. të Ligjit nr. 04/L-163 për Mallrat e Liruar nga Tatimi Doganor dhe Mallrat me Tarifë Zero të Tatimit Doganor, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjesisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 14/2017, me Rregulloren nr. 15/2017 dhe me Rregulloren nr. 16/2017, si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 11 prill 2018, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohen lirimet nga tatimi doganor për të gjitha pjesët rezervë për subjektet e regjistruara në Administratën Tatimore të Kosovës si subjekte prodhuese (subjekte të cilat posedojnë autorizime për lirim nga tatimi për lëndën e parë) me tatim zero doganor.
2. Obligohet Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Ramush HARADINAJ


Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë